

KOMUNA RAHOVEC



BULETINI MUJOR KOMUNAL

QERSHOR 2021

Zyra e Kryetarit

**Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut
p.n, 21000, Rahovec – Kosovës**

Tel : 0382004534

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOŠOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINETI I PRESEDNIKUT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No	757	Nr. i faq./Br./No pg 240
Data/Datum/Date	21 / 9 / 21	
RAHOVEC / ORAHOVAC		

BULETINI MUJOR KOMUNAL

HYRJE

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të aktiviteteve të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive përgjatë muajve të vitit 2021, rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për informacionet mbi vendimet, zbatimin e politikave dhe rezultatet e aktiviteteve të Komunës së Rahovecit në mënyrë të tillë që të mundësojmë që qytetari të ndjekë dhe të kontribuojë në mënyrë efektive në punën e institucioneve lokale.

Me anë të këtij buletini mujor për muajin qershor, ne jemi munduar të paraqesim me fotografi dhe në detaje aktivitetet nga ana e Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit.

BULETINI MUJOR KOMUNAL

AKTIVITETE TË KRYETARIT DHE DREJTORËVE TË DREJTORIVE



Sipërfaqet e mbrojtura (serrat), ndikojnë në rritjen e cilësisë së prodhimeve bujqësore, njëkohësisht edhe në sigurinë e tyre nga fatkeqësitë natyrore. Përmes përkrahjes nga kompania konsulente për hartim të projekteve kemi arritur të fitojmë grante nga Ministria e Bujqësisë për fermerët e komunës sonë.

Kryetari Smajl Latifi ka pritur në takim shefin e ri të misionit të Organizatës për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë- OSBE, z. Michael Davenport, të cilit i shprehu edhe mirënjohjen e komunës së Rahovecit ndaj OSBE-së, që në vazhdimësi ia kanë ofruar ndihmën dhe mbështetjen në mbrojtjen, promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe ngritjen e kapaciteteve për funksionim më të mirë të sistemit tonë të vlerave dhe të demokracisë.



Rikthyem kujtesën tonë te ngjarjet e luftës së UÇK-së në Drenoc, Senoc e Polluzhë, Krushë të Madhe dhe Celinë tek ato shumë familje fisnike që i hapën zemrat dhe shtëpitë të cilat u shndërruan në baza të fuqishme të luftës sonë çlirimtare. Në 143 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e në vigjilie të 14 qershorit- Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit, në shenjë mirënjohjeje, zbuluam pllakat përkujtimore në Drenoc, Senoc, Krushë të Madhe, Polluyhë dhe Celinë.

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Kryetari Smajl Latifi bashkë me drejtorin e bujqësisë, Berat Durakun, morën pjesë në garën komunale të peshkimit të organizuar nga Shoqata e peshkatarëve Sportiv "AMUR" nga Rahoveci, që u mbajtën në Krushë të Madhe.

Lufta dhe rezistenca për lirinë e Kosovës është frymëzim dhe vepër e popullit! Prandaj, Ditën e Çlirimit të Rahovecit Kryetari Smajl Latifi e filloi duke pritur në komunë qytetarë të Rahovecit, me të cilët shkëmbyen urimet më të përzemërta me rastin e festës sonë.



Në Ditën e Çlirimit të Rahovecit, Kryetari Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, përfaqësues të OVL-së, familjarë të të rënëve, kanë bërë homazhe dhe nderime në varrezat e dëshmorëve dhe vendet që kujtojnë ata që sakrifikuan gjithçka për të arritur në këtë ditë.

Lavdi të rënëve për liri!

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Zbulimi i shtatoreve të heronjve të kombit Feim e Bedrush Gashi!



Në QKMF "Fahredin Hoti", ka filluar vaksinimi masiv kundër Covid-19.



Për nder të 17 qershorit, ditëlindjes së intelektualit dhe atdhetarit të çështjes kombëtare, prof. Ukshin Hoti, në Krushë të Madhe, është vënë gurthemeli për ndërtimin e fazës së dytë të "Kompleksit Muzeal të Ukshin Hotit".

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Është shënuar Dita Botërore Olimpike Rahovec!

20% e polisës së sigurimit do të mbulohet nga komuna e Rahovecit për kulturat tona bujqësore



Kryetari Smajl Latifi, bashkë me drejtoreshën e DKRS-së, znjsh.Bjondina Kleqka morën pjesë në hapjen e ekspozitës të edicionit të 20-të, të Kolonisë Ndërkombëtare të Artit.

BULETINI MUJOR KOMUNAL



Komuna e Rahovecit përfiton nga Granti i Bankës Botërore 250,000.00 dollarë. Kryetari Smajl Latifi me ministrin e MPL-së z. Elbert Krasniqi, kam nënshkruar marrëveshje në bazë të cilës komuna e Rahovecit është përfituese në kuadër të projektit "Komunitat për të rinjtë në Kosovë", i cili financohet nga qeveria japoneze përmes Bankës Botërore. MPL, përmes kësaj marrëveshjeje do të financojë 85% të projektit, pra 250,000.00 dollarë, ndërsa komuna e Rahovecit do të participojë me të paktën 15% - 37,500.00 dollarë.



Kryetari Smajl Latifi ka zhvilluar takimin e parë publik me qytetarët në sallën e Kuvendit Komunal të Rahovecit, ku ka prezantuar punën për 6-mujorin e parë të vitit 2021.

Një trashëgimi natyrore ruhet në gjirin e saj.

Zonës së Gradishit, e cila ka një histori të gjatë që nga ilirët e deri në ditët tona, ku legjendat dhe gojëdhënat janë përfjellur brez pas brezi e jetojnë edhe sot, ju shtua edhe një projekt i financuar nga komuna e Rahovecit-Shtegu për Ecje, i gjatë 1600 metra, me gjerësi 3 metra, me ulëse për vizitorë që e përshkojnë atë, me ndriçim publik, e parking dhe me tri pushimore në buzët e brigjeve të kanionit të Drinit të Bardhë.



BULETINI MUJOR KOMUNAL



Në Sapniq përruam ndriçimin publik në gjatësi 3km, që mbulon 95% të fshatit.

Parku në Brestoc!

Duke e parë rëndësinë e mjedisit e sidomos gjelbërimit, gjithnjë e më shumë komuna e Rahovecit, është duke u angazhuar në krijim të hapësirave të gjelbëruara, pasi ato ofrojnë përfitime të mëdha si për mjedisin ashtu edhe për banorët.



Në kuadër të zbatimit të projektit "Riparime në shkolla", kanë filluar punimet në rregullimin e oborrit të shkollës fillore në fshatin Dejnë, me ç'rast në këtë oborr do të ndërtohet parking për nevojat e shkollës.

BULETINI MUJOR KOMUNAL

PËRFUNDIM

Ky buletin përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe:

(qershor 2021).

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, korrik 2021